

**A JENI GATI TE PERDORNI SHERBIMIN 'INTESA MOBILE'?**

I nderuar Klient,

Buletini i këtij muaji do t'ju motivoj që të përdorni aplikacionin tuaj 'Intesa Mobile' duke evidentuar përfitimin e veçantë që ofron ky shërbim, të cilin dëshirojmë t'ju sjellim në vëmendjen tuaj: 'Opsioni i Aksesit të shpejtë', një mënyrë e thjeshtë dhe e shpejtë, i cili do të lehtësojë përdorimin tuaj të 'Intesa Mobile'.

**INTESA MOBILE – OPSIONI 'AKSES I SHPEJTE' – I THJESHTE DHE I SIGURT:**

Nëpërmjet shërbimit 'Intesa Mobile', ju do të keni të gjitha shërbimet bankare shumë pranë! A mund ta imagjinoni që të përdorni shërbimet bankare shumë herë në ditë pa qenë personalisht i pranishëm në bankë? Po është e vërtetë! Ju mund të përdorni shërbimet bankare në mënyrë të shpejtë dhe të përshtatshme: vetëm aktivizoni opsionin 'Akses i shpejtë', i cili ju mundëson hyrjen në aplikacionin 'Intesa Mobile' për të parë informacion mbi gjendjen tuaj financiare pa pasur nevojë të vendosni kodin e çelësit të sigurisë.

**NEPERMJET OPSIONIT 'AKSES I SHPEJTE' JU DO TE:**

- Kontrolloni detajet, gjendjen dhe aktivitetin e llogarisë/ve tuaj/a.
- Kontrolloni detajet dhe gjendjen e depozitës/ave tuaj/a.
- Kontrolloni detajet dhe gjendjen e kredisë/ve tuaj/a.
- Shikoni statusin e transaksioneve që keni kryer.
- Shikoni informacionin për kurset e këmbimit valutor.
- Aksesoni shërbimin e kutisë postare.

**KESHILLA TE TJERA**  
**HAPAT PER AKTIVIZIMIN E APLIKACIONIT**  
**'AKSES I SHPEJTE - INTESA MOBILE':**

1. Në fillim aktivizoni shërbimin tuaj 'Intesa Mobile' duke përdorur kredencialet tuaja dhe Çelësin e Sigurisë.
2. Lundroni nëpërmjet menusë kryesore tek 'Shërbimet me Klientët'.
3. Klikoni opsionin 'Hyrje e shpejtë'.
4. Tek opsioni 'Kerko çelësin e sigurisë', zgjidh opsionin 'Jo' dhe shtyp 'Dërgo'.



Pas këtyre hapave, ju mund të aksesoni financat tuaja në çdo kohë që dëshironi thjesht duke vendosur emrin e përdoruesit dhe fjalëkalimin, pa qenë e nevojshme që të keni çelësin e sigurisë me vete gjatë gjithë kohës. Gjithsesi, nëse do të kryeni një transaksion, megjithëse është aktivizuar ky opsion, ju do të duhet të vendosni kodin e çelësit të sigurisë. Ju mund të aktivizoni këtë tipar duke ndjekur të njëjtët hapa.

**Asnjëherë nuk është vonë që të përfitoni të mirat e shërbimit 'Intesa Mobile'.**